

VENDIM
Nr.415, datë 28.6.2006

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË KOMPANIE USHTARAKE SLOVENE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, date 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kompanisë ushtarake të transportit, SIKON KFOR, të Forcave të Armatosura të Republikës së Sllovenisë, të përbërë prej 90 (nëntëdhjetë) trupash dhe 41 (dyzet e një) mjeteve ushtarake, të kalojë transit përmes territorit të Republikës së Shqipërisë për në Republikën e Maqedonisë.

2. Hyrja e trupave ushtarake sllovene, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, në territorin e Republikës së Shqipërisë, të bëhet në portin e Durrësit, më datë 29.6.2006. Lëvizja e karvanit ushtarak, gjatë kalimit transit, do të ndjekë itinerarin Durrës-Elbasan-Qafë-Thanë. Dalja nga territori i Republikës së Shqipërisë të bëhet në pikën e kontrollit të kalimit kufitar Qafë-Thanë me datë 30.6.2006.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/dhe nga Republika e Shqipërisë, janë parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, me 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve pale në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, me 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Karvani ushtarak slloven, gjatë itinerarit të lëvizjes të shoqërohet nga një njësi e armatosur e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha